



VENDIM

Nr. 140, Datë 22.11.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
SË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 dhe 9, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionereve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.11.2013, mbasi shqyrtoi draftin e propozuar nga ana e Oportatorit të Sistemit të Transmeimit si dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Vendosi:

1. Të miratojë rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit (Rregullorja, bashkëngjitur këtij vendimi).
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe do ketë efekt deri në hyrjen në fuqi të Zyrës Rajonale të Koordinimit të Ankandëve.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST SH.A për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s
Petrit AHMETI

**RREGULLAT
PER
ALOKIMIN E KAPACITETEVE TE INTERKONJEKSIONEVE**

PERMBAJTJA

KAPITULLI I - HYRJE DHE DISPOZITA TE PERGJITHSHME

KAPITULLI II - SHKURTIME DHE PERCAKTIME

KAPITULLI III - DOKUMENTET DHE FORMULARET

**KAPITULLI IV - PERCAKTIMI I KAPACITETIT TRANSMETUES
DISPONIBEL (ATC)**

KAPITULLI V - PERSHKRIMI I PROCEDURES SE ALOKIMIT

KAPITULLI VI - TRANSFERIMI I KAPACITETIT TE ALOKUAR

**KAPITULLI VII - ZBATIMI I TE DREJTES SE PERDORIMIT TE
KAPACITETIT NDERKUFITAR TE ALOKUAR**

**KAPITULLI VIII - KUFIZIMI I TE DREJTES SE PERDORIMIT TE
KAPACITETIT TE ALOKUAR NE ANKAND**

**KAPITULLI IX - PUBLIKIM I INFORMACIONIT NE FAQEN E
INTERNETIT TE OST SH.A**

KAPITULLI X – MONITORIMI I ALOKIMIT TE KAPACITETEVE

KAPITULLI XI – MIRATIMI DHE RISHIKIMI

KAPITULLI XII - HYRJA NE FUQI

1. HYRJJE DHE DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Keto Rregulla hartohen ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike” (i ndryshuar), Modelitte Tregut te Energjise Elektrike, te miratuar me VKM Nr. 338, date 19.3.2008 dhe Rregullave te Tregut Shqiptar te Energjise Elektrike, te miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me Vendimin Nr. 68, date 23.6.2008.

Keto Rregulla specifikojne procedurat dhe kriteret e ankandit per alokimin e kapaciteteve disponibel nderkufitar, ne te dy drejtimet import/eksport, ndermjet zones se kontrollit te OST sh.a dhe Operatoreve te Sistemit te Transmetimit te vendeve fqinje.

Keto rregulla percaktojne kerkesat qe pjesmarresit e tregut duhet te permbushin per te marre pjese ne ankandet Vjetore, Mujore dhe Alokimin Ditore, procedurat e zhvillimit te ankandit, dhenien e te drejte se transmetimit fizik, kushtet per akses ne tregun sekondar te se drejtes se transmetimit fizik dhe shfrytezimin e te drejtes se transmetimit fizik.

Kapacitetet e Transmetimit Disponibel (ATC) per eksport nga Shqiperia dhe per import ne Shqiperi, alokohen ne menyre eksplicite nepermjet ankandit Vjetor, Mujor dhe Ditor te mbajtur per secilin kufi dhe drejtim te fluksit te energjise.

Keto rregulla kane per qellim qe te sigurojne nje process transparent dhe te monitoruar nga ana e Entit Rregullator te Energjise per alokimin e kapaciteteve disponibel te interkoneksionit.

OST si Operator i Sistemit te Transmetimit ne Republiken e Shqiperise, eshte i ngarkuar te percaktoje vlerat e kapacitetit transmetues nderkufitar dhe rakordimin e tyre me TSO-te fqinje ne perputhje me kriteret e percaktuar nga ENTSO-E (Rrjeti Europian i Operatoreve te Transmetimit te Energjise Elektrike).

Ne rast te ndryshimit ose miratimit te Rregullave te reja tealokimit te ATC, per vitin kalendarik pasardhes, ato do te publikohen ne faqen e internetit te OST, brenda 10 diteve nga miratimi i tyre nga ERE. Pas publikimit te Rregullave, pjesemarresit e tregut jane te detyruar te ndjekin ne menyre korrekte rregullat e publikuara ne faqen e internetit te OST.

2. SHKURTIME DHE PERCAKTIME

TTC (Total Transfer Capacity) Kapaciteti Total Transmetues - eshte programi i shkembimit maksimal ndermjet zonave te kontrollit te shoqeruara me standartet e sigurise se operimit ne te dy sistemet, mbi bazen e informacionit disponibel te operimit te pritshem te rrjetit, perfshire gjenerimin dhe ngarkesen.

TRM (Transmission Reliability Margin) Rezerva e Sigurise se Sistemit te Transmetimit - eshte nje pjese e kapacitetit transmetues nderkufitar, e nevojshme per punen e sigurte te sistemit transmetues duke konsideruar pasaktesine e llogaritjes se kapaciteteve transmetuese dhe skedulimeve qe mbesheten mbi to. Kjo pasaktesi rrjedh si rezultat i operimit te rregullimit sekondar, nevojës per shkembime emergjente dhe devijimeve ne kohe reale, nga skedulimi. TSO-te fqinje rakordojne bashkarisht vleren e TRM.

NTC (Net Transfer Capacity) Kapaciteti Neto i Transmetimit - eshte programi maksimal i shkembimit ndermjet dy TSO-ve fqinje duke konsideruar standartet e sigurise te zbatueshme ne te gjitha zonat e kontrollit te zones sinkrone, si dhe duke konsideruar gjithashtu pasigurine teknike qe lidhet me parashikimin e kushteve te punes se rrjetit, dhe llogaritet sipas formulese se meposhtme:

$$NTC = TTC - TRM$$

AAC (Already Allocated Capacity) Kapaciteti Transmetues i Alokuar - eshte gjithë kapaciteti transmetues, qe tashme i eshte alokuar pjesmarresve te tregut ne

baze te ketyre rregullave, pas plotesimit te detyrimeve financiare kundrejt OST-se nga ana e pjesmarresve te tregut.

ATC (Available Transmission Capacity) Kapaciteti Transmetues Disponibel - eshtediferenca ndermjet kapacitetit neto dhe kapacitetit tashme te alokuar, dhe llogaritet sipas formule se meposhtme:

$$ATC = NTC - AAC$$

Pjesmarres i Tregut - eshte nje entitet juridik i regjistruar ne Shqiperi, i licensuar nga ERE per kryerjen e nje ose me shume aktiviteteve ne sektorin energjetik dhe qe i eshte nenshtruar te gjitha procedurave te parashikuara nga aktet ligjore e nenligjore ne fuqi per regjistrimin ne tregun e energjise elektrike. Eshte nje entitet juridik i regjistruar ne Shqiperi, i licensuar nga ERE per kryerjen e nje ose me shume aktiviteteve ne sektorin energjetik, dhe qe ka nenshkruar me OST Kontraten per perdorimin e kapacitetit nderkufitar.

Pjesmarres i Ankandit - eshte pjesmarresi i tregut qe paraqet ne ankand kerkesen per alokimin e te drejtes se transmetimit te kapacitetit nderkufitar, ne perputhje me keto rregulla.

Periudha e Ankandit - eshte periudha ne te cilen aplikohet alokimi i kapacitetit. Alokimi i kapaciteteve realizohet nepermjet ankandeve vjetore, mujore, javore apo alokimeve ditore.

Oferta e Ankandit - jane vlerat e ciftit kapacitet – cmim (MW - €/MWh) ne kerkesen e paraqitur nga pjesmarresi ne ankand.

Alokimi- eshte procesi me te cilin OST i atribuon kapacitet e transmetimit tek pjesmarresit e tregut.

Ankandi Vjetor - eshte ankandi per alokimin e te drejtes se transmetimit fizik per vitin pasardhes.

Kapaciteti Transmetues Disponibel (ATC) Vjetor –eshtepjesa e Kapacitetit Transmetues Disponibel qe alokohet ne ankandin vjetor ne formen e te drejtes se transmetimit fizik.

Ankandi Mujor –eshteankandiper alokimin e te drejtes se transmetimit fizik per muajin pasardhes.

Kapaciteti Transmetues Disponibel (ATC) Mujor - eshtepjesa e kapaciteteve te transmetimit disponibil qe alokohet ne ankandin mujor per muajin pasardhes.

Alokim Ditor - eshte procedura per alokimin e te drejtes se transmetimit fizik per ditën pasardhese.

Kapaciteti Transmetues Disponibel Ditor - eshtepjesa e Kapaciteti Transmetues Disponibel qe alokohet ne ankandin ditor.

Kushtet Specifike te Ankandit - do te thoteinformacioni i nevojshem qe ju vihet ne dispozicion pjesmarresve te ankandit nga OST sh.a.ne faqen e internetit per nje ankand te caktuar.

Mjetet e Ankandit - do te thotesistemi i teknologjise se informacionit (IT) i perdorur nga OST per te marre ofertat nga pjesmarresit e ankandit, perfshire kryerja e veprimeve dhe shpallja e rezultatit te ankandit.

Faqja e Internetit te Ankandeve - eshtefaqja e internetit te OST-se (Operatori i Tregut) me permbajtjen e percaktuar ne nenin 9 te ketyre Rregullave.

Dita e Ankandit - eshtedita ne te cilen do te zhvillohet ankandi, per te cilin ofertat mund te paraqiten deri ne afatin e percaktuar nga OST-ja.

Konxhestion (pamjaftueshmeri) – paraqet situaten kur kerkesa per kapacitet transmetues e paraqitur nga pjesmarresit ne ankand (si shumatore) eshte me e madhe se kapaciteti disponibil ATC ne kufirin/drejtimin perkates te publikuar nga OST.

Cmimi marxhinal - eshte cmimi me i ulet i ofertes se fundit te pranuar nga OST ne nje proces ankandi.

Zoteruesi i kapacitetit - eshte pjesmarresi qe fiton te drejten e transmetimit nderkufitar ne ankand ose qe e fiton kete te drejte nga vendimet perkatese te ERE-s, dhe procedurave te alokimit te OST-se, si dhe nepermjet transferimit ne perputhje me kerkesat e ketyre rregullave.

Tregu Sekondar i te Drejtes se Transmetimit Fizik - eshtemekanizmi qe lejon transferimin e te drejtes se transmetimit fizik te blere ne ankandin Vjetor dhe /ose Mujor nga mbajtessi qe e ka fituar ne ankand tek nje pjesmarres tjeter i tregut sipas ketyre rregullave.

Transferimi i kapacitetit - eshte transferimi i te drejtes se perdorimit te kapacitetit nderkufitar nga zoteruesi i kapacitetit tek nje pjesmarres tjeter i tregut.

Shkembimi nderkufitar i energjise - eshte shkembimi i energjise elektrike qe pjesmarresi i tregut ne Shqiperi, kryen me pjesmarresit e tregut ne zonat e kontrollit (TSO-te) fqinje.

Partneri nderkufitar - eshte nje person nga zona e kontrollit fqinje me te cilin pjesmarresi i tregut ne Shqiperi ka nje kontrate shkembimi nderkufitar.

Zone kontrolli - eshte pjesa e percaktuar e rrjetit interkonektiv European (ENTSO-E), qe kontrollohet nga nje Operator (TSO).

ERE - eshteEnti Rregullator i Energjise sipas percaktimit te bere ne ligjin per Sektorin e Energjise Elektrike

ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity) - eshte shoqata e TSO-ve Europiane te energjise elektrike.

3. DOKUMENTET DHE FORMULARET

Dokumentet dhe formularetbashkengjitur si anekse jane pjese perberese e ketyre Rregullave dhe OST-ja i publikon ato ne faqen e saj te internetit:

- Formulari i paraqitjes se ofertes – Shtojca 1
- Formulari i njoftimit te rezultateve te ankandit– Shtojca 2
- Formulari i detajeve te fatures – Shtojca 3
- Formulari i transferimitte kapacitetit - Shtojca 4
- Modeli i kontrates – Shtojca 5
- Plani vjetor i remonteve – Shtojca 6
- Formulari i deklarimit te ATC se fituar ne TSO fqinje– Shtojca 7

- Lista e pjesmarresve te tregut qe mund te marrin pjese ne ankand – Shtojca 8
- Formulari i njoftimit te ankandit vjetor/mujor– Shtojca 9

4. PERCAKTIMI I KAPACITETIT TRANSMETUES NDERKUFITAR DISPONIBEL (ATC)

Siguria e punes se Sistemit Energjetik qe punon ne interkoneksion eshte e lidhur ngushtesisht me vleresimin dhe percaktimin e kapacitetit transmetues nderkufitar.

Percaktimi i kapacitetit transmetues nderkufitar behet sipas Marreveshjeve bilaterale ndermjet TSO-ve fqinje, dhe bazohet ne Manualin e ENTSO-E, respektivisht ne Politiken Nr. 4, dhe Aneksin e saj.

Barrierat ne shkembimin e energjise shkaktohen kryesisht nga kapaciteti i limituar i rrjetit interkonektiv, qe nenkupton jo vetem interkonektoret (linjat nderkufitare) por cdo element te rrjetit te brendeshem qe behet shkak per limitimin e transaksioneve apo cvendosjen e energjise nga nje zone ne nje tjetër. Kongjestioni ne transmetim ndodh kur sistemi nuk mund te punoje i sigurte ne kushtet e nje modeli te dhene te gjenerimit, shkembimit, transmetimit dhe kerkeses. Procedura e menaxhimit te kongjestionit nenkupton clirimin e rrjetit nga konxhestioni, pra marrjen e masave per te mos lejuar shkeljen e normativave fizike qe sigurojne punen normale te rrjetit.

Nocionet fundamentale te ENTSO-E lidhur me kapacitetin transferues, jane:

Kapaciteti total i transmetimit (TTC) perfaqeson vleren max te programit te shkembimit ndermjet dy TSO-ve, duke plotesuar standartet e sigurise se punes te detyrueshme per cdo Sistem, nese per periudhen per te cilen behet vleresimi i TTC, kushtet e rrjetit dhe modeli gjenerim – konsum, njihen mire ne avance. TTC eshte gjithmone e lidhur me situaten e dhene te Sistemit, d.m.th. me modelin gjenerim – konsum dhe situaten e elementeve te rrjetit, qe perbejne bazen e te dhenave per formimin e modelit matematik te Sistemit. Zgjidhja e ketij modeli jep rezultatet per vlerat e tensionit ne nyjet e Sistemit dhe ngarkesen (rrymen) ne te gjitha qarqet e tij, te cilat perfaqesojne parametrat qe duhet te monitorohen nga Operatori i Sistemit per vleresimin e sigurise se punes.

Meqe llogaritjet bazohen ne parashikimin e situates ne te ardhmen, ekziston mundesia e shfaqjes se pasaktesive te rezultatit, te cilat jane ne varesi te periudhes kohore qe merret ne konsiderate. Sa me e afert te jete periudha per te cilen behen llogaritjet aq me te sakta jane rezultatet e llogaritjes se TTC. Per kete arsye merret ne konsiderate nje sasi e caktuar kapaciteti qe sherben (pervec te tjerave) edhe per


kompensimin e pasaktive ne llogaritje, e quajtur TRM. Atehere vlera e kapacitetit neto te transmetimit NTC percaktohet sipas formule: $NTC = TTC - TRM$. Llogaritja e TTC fillon e me vendosjen e rastit baze, i cili paraqet nje situatë (skenar) te rakorduar tashme nga palet dhe te provuar (nga eksperienca e meparshme) se i ploteson te gjitha kushtet e sigurise se punes per secilen nga palet. Ne rastin baze, programi i shkembimit ndermjet te dy paleve mund te jete zero ose jo, ne varesi te situates. Duke filluar nga kjo situatë (pas shkembimit te te dhenave respektive) per te llogaritur TTC nga zona A ne zonen B, generimi rritet me hapa te caktuar ne zonen A dhe ulet ne te njejten mase ne zonen B, duke shkaktuar ne kete menyre ndryshimet perkatese ne rrjedhen e fluksit te energjise ne te dy zonat. Ndryshimi i gjenerimit eshte shenuar me ΔE^+ dhe ΔE^- per rritjen dhe uljen respektive te gjenerimit. Ky proces vazhdon deri ne piken kur ne njerin nga sistemet A ose B cenohet siguria e punes ($\Delta E_{max}^+ / \Delta E_{max}^-$). Maksimumi i shkembimit nga A ne B qe eshte kompatibel me rregullat e sigurise se punes, pra TTC nga A ne B – eshte $BCE + \Delta E_{max}^+$. Kjo procedure perseritet per drejtimin e kundert, pra ulje e gjenerimit ne A dhe rritje ne B, per llogaritjen e TTC nga zona B ne ate A.

Procedura e rakorduar ndermjet paleve per kryerjen e kalkulimeve paraqitet si me poshte:

1. Cdo TSO pregatit modelin e rrjetit sipas formatit te aprovuar (UCT) per rastin baze, i cili paraqet nje situatë (skenar) te rakorduar tashme nga palet dhe te provuar (nga eksperienca e meparshme) se i ploteson te gjitha kushtet e sigurise se punes per secilen nga palet, dhe ben testimin e konvergjences me programin e shperndarjes se fluksit te energjise (PSS/E, TNA). Gjithashtu percaktohen centralet (nyjet) ku do te behet rritja e ngarkeses ne rastin e eksportit, ose ulja e ngarkeses ne rastin e importit, sipas nje shkallezimi te caktuar per te dy drejtimet rritje/ulje.
2. Behet shkembimi i modeleve ndermjet TSO-ve dhe formohet modeli rajonal nga koordinatori i radhes (me rotacion) dhe i behet disponibel cdo TSO pjesmarrese. Nga ky model (rasti baze) percaktohet madhesia dhe drejtimi i fluksit qarkullues.
3. Behet harmonizimi i programeve te shkembimit eksport/import ($\sum = 0$) dhe fillon simulimi i modelit me hapin prej 10 - 50 MW. Per cdo hap behet regjistrimi i fluksit ne linjat interkonektive, dhe behet verifikimi i plotesimit te kriterit N-1 (N-2, per linjat dyfishe), per rastin e rrezimit te agregateve kontrollohet edhe devijimi i frekuences.

4. Amplituda me e madhe e shkembimit per te cilen nuk cenohet niveli i tensionit dhe limiti i rrymes, pranohet si transakcion i mundeshem. Shuma ndermjet kesaj vlere me vleren e regjistruar ne rastin baze, jep vleren e kapacitetit total TTC per cdo kufi.

Diagrama e metodologjise se perdorur



Pra, thelbi i kesaj procedure konsiston ne pregatitjen dhe shkembimin e te dhenave te rrjetit ndermjet kompanive transmetuese te rajonit dhe formimin e modelit rajonal te transmetimit, mbi te cilin behet kontrolli i simulimit te cvendosjes se energjise nga nje zone ne tjetren. Llogaritjet behen nga cdo TSO duke kontrolluar nivelin e sigurise se punes per zonen e vet ne rast se hapet (del nga puna) nje linje e caktuar interkonektive ose nje element i rrjetit te brendeshem te transmetimit. Vlerat e kapacitetit TTC percaktohen vecmas per cdo kufi dhe drejtim fluksi, dhe ato nuk mund te mblidhen, pra te eliminohen nepermjet nxjerrjes se vleres neto te transmetimit. Kontrolli perfshin rrjetin e nivelit 220 kV dhe 400 kV. Amplituda me e madhe e kapacitetit per te cilen nuk cenohet siguria e punes (niveli i tensionit dhe limiti i rrymes), pranohet si kapaciteti total i mundeshem ne ate pike kufitare. Kapaciteti neto del duke zbritur nga kapaciteti total marzhin e sigurise (TRM) qe

merr ne konsiderate gabimet e mundeshme ne llogaritje, pasi te dhenat i referohen situates se rrjetit qe parashikohet te jete ne muajin e ardheshem, si dhe lenies se nje kapaciteti rezerve qe mund te perdoret ne raste emergjence te renies se pjeseshme ose te plote te ndonje zone ne interkoneksion. Me marreveshje ky kapacitet eshte 50 MW per interkonektoret e nivelit 220 kV dhe 100 MW per ato te nivelit 400 kV.

Ne rast se nga llogaritjet qe behen nga cdo TSO rezultojne dy vlera te ndryshme te TTC, **atehere konsiderohet vlera me e vogel**. Pra ne rastet e mos-harmonizimit ndremjet TSO-ve fqinje, zbatohet principi i pranimit te minimumit te dy vlerave te TTC ne te njejtin kufi dhe drejtim.

Vlerat mujore te NTC, si rregull, duhet te llogariten dhe te harmonizohen me TSO-te fqinje per cdo kufi vecmas, brenda dates 7 te cdo muaji, per muajin e ardheshem.

Per kete ndiqet procedura e meposhtme:

- 10 dite para perfundimit te afatit te harmonizimit, shkembihen te dhenat, modeli nacional me te gjitha nyjet e nivelit 220/400 kV, ndermjet TSO-ve, ne formatin e aprovuar UCT, perfshire rezerven e fuqise aktive per rritjen/uljen e gjenerimit, dhe te dhena mbi programin e remonteve (elementet jashte pune) per periudhen e konsideruar,
- 5 dite para perfundimit te afatit te harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) per vlerat e TTC/NTC qe rezultojne nga plotesimi i kriterit N-1 te zbatuar per cdo zone kontrolli,
- 2 dite para perfundimit te afatit te harmonizimit, shkembihen vlerat e percaktuara te TTC per cdo kufi, dhe fillon procesi i harmonizimit te tyre. Ne rast mosperputhje te vlerave te llogaritura, dhe nese palet nuk arrijne te bindin njera tjetren, atehere vlera me e vogel e TTC hyn automatikisht ne force.

Si rregull, shuma e kapacitetit te shkembimit per te gjitha kufite, shumezohet me koeficientin 0.7, per te percaktuar importin/eksportin total te nje zone, duke bere reduktimin proporcional per cdo kufi, dhe qe merret ne konsiderate ne procesin e alokimit te kapacitetit nderkufitar. Vlera vjetore e NTC per cdo interkonektor dhe drejtim fluksi, llogaritet duke konsideruar vleren minimale mujore qe eshte perdorur, shfrytezuar, ne tre vitet e fundit, dhe rakordohet me TSO-te fqinje.

Ne rast te ndryshimeve sinjifikative te situates se Sistemit ne krahasim me situaten e parashikuar, kur jane llogaritur kapacitetet nderkufitare, TSO-te fqinje, pas shkembimit te te dhenave relevante te situates se re, bejne ri-kalkulimin e

kapacitetit nderkufitar, dhe percaktojne bashkarisht vlerat e reja te NTC e respektivisht ato te ATC.

Kjo procedure ndiqet nga cdo TSO e rajonit, bazuar ne Udhezuesin Operacional te ENTSO-E, per llogaritjen e kapaciteteve transmetuese nderkufitare.

5. PERSHKRIMI I PROCEDURES SE ALOKIMIT

5.1. Metoda e alokimit te se drejtes te perdorimit te ATC

OST organizon ankande vjetore, mujore dhe alokim ditor te rezervimit te se drejtes se perdorimit te kapacitetit disponibel (ATC), te vecante per cdo kufi dhe drejtim si me poshte:

- a) Ankandet vjetore ne lidhje me te drejatat e transmetimit fizik (PTR) per kapacitetet e transmetimit disponibel (ATC) vjetore nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor .
- b) Ankandet mujore ne lidhje me te drejatat e transmetimit fizik (PTR) per kapacitetet e transmetimit disponibel (ATC) Mujore nga dita e pare deri ne ditën e fundit kalendarike te muajit per vitin perkates;
- c) Alokim ditor ne lidhje me te drejatat e transmetimit fizik (PTR) per kapacitetet e transmetimit disponibel (ATC) ditore ne periudha rezervimi nga ora 00.00 deri ne oren 24.00 te cdo dite.

OST alokon ATC ne interkonjeksione, ne periudha rezervimi Vjetore dhe Mujore, ne ankand ekspllicit. Cmimi i ankandit eshte cmimi marxhinal, pra cmimi i ofertes me te ulet te pranuar ne ankandin perkates.

Ankandet vjetore

Vlera vjetore e ATC per cdo kufi e drejtim publikohet, sipas formularit ne shtojcen nr. 9, jo me vone se data 25 Nentor e vitit V-1, per vitin V, dhe ankandi vjetor organizohet jo me vone se data 30 Nentor. Informacioni perkates lidhur me ankandin vjetor do te publikohet ne faqen web te OST-se. Procedurat e ankandit, ofertat e paraqitura nga pjesemarresit ne ankand dhe rezultatet e ankandit do te aplikohen ne perputhje me keto rregulla dhe udhezimet perkatese te OST.

Ne mungese te platformes se Softit, ofertat e ankandit vjetor do te dorezohen nga ofertuesit ne zarfe te mbyllur. Ofertat e pjesemarresve ne ankand hapen nga

perfaqesuesit perkates te OST-se dhe ne prezence te perfaqesuesve te autorizuar te pjesmarresve ne ankand lexon te dhenat e ofertes si vijon:

- Emrin e ofertuesit
- Kufirin per te cilin eshte kerkuar kapaciteti
- Drejtimin per te cilin eshte kerkuar kapaciteti
- Periudha per te cilin eshte kerkuar kapaciteti (sipas publikimit nga OST)
- Kapacitetin e kerkuar ne MW
- Cmimin njesi te cdo oferte Euro/MWh

Te paraqitur sipas shtojces nr 1 te ketyre Rregullave

E drejta e perdorimit te kapacitetit nderkufitar te alokuar ne ankandet vjetore do te aplikohet nga ora 00:00 e dates 1 Janar deri ne ora 24:00 te dates 31 Dhjetor.

Gjate periudhave te remonteve te linjave te interkonjeksionit, OST redukton te drejten e perdorimit te kapacitetit te alokuar ne ankandet vjetore, ne menyre proporcionale me reduktimin e vleres se ATC ne keto periudha.

Ankandet mujore

Vlerat mujore te ATC per muajin M publikohen, sipas formularit ne shtojcen nr. 9, jo me vone se data 15 e muajit M-1, dhe ankandet mujore per muajin M organizohen njekohesisht per te gjitha periudhat e rezervimit, drejtimet dhe kufijte, jo me vone se data 20 e muajit M-1. Informacioni perkates lidhur me ankandin mujor do te publikohen ne faqen e internetit te OST-se.

Ofertat e ankandit mujor do te dorezohen nga ofertuesit ne zarfe te mbyllur.

Per ankandet mujore, nese per ndonje kufi e drejtim, ka disa periudha kohore me vlera te ndryshme te ATC, atehere per cdo periudhe organizohet nje ankand i vecante per vleren perkatese te ATC.

Ne mungese te platformes se Softit, ofertat e pjesmarresve ne ankand hapen nga perfaqesuesit perkates te OST-se dhe ne prezence te perfaqesuesve te autorizuar te pjesmarresve ne ankand lexon te dhenat e ofertes si vijon:

- Emrin e ofertuesit
- Kufirin per te cilin eshte kerkuar kapaciteti
- Drejtimin per te cilin eshte kerkuar kapaciteti

- Periudha per te cilen eshte kerkuar kapaciteti (sipas publikimit nga OST)
- Kapacitetin e kerkuar ne MW
- Cmimin njesi te cdo oferte Euro/MWh

Te paraqitur sipas shtojces nr 1 te ketyre Rregullave

E drejta e perdorimit te kapacitetit nderkufitar te alokuar ne ankandet mujore do te aplikohet nga ora 00:00 e dites se pare te muajit M, deri ne ora 24:00 te dites se fundit te periudhes perkatese qe do te publikohet ne tabelen e vlerave te ATC per muajin ne fjale.

OST njofton TSO-te fqinje per rezultatet e ankandit vjetor dhe mujor (emrin, kodin e kompanise dhe kapacitetin qe i alokohet) – jo me vone se tre (3) dite pune para fillimit te muajit pasardhes

Alokimi ditor

Kapaciteti disponibel ditor, per cdo kufi dhe drejtim, per ditën D, perbehet nga **shuma** e kapacitetit te paalokuar ne ankandin perkates mujor, me kapacitetin ‘e kthyer’ te deklaruar nga pjesmarresit perkates qe nuk do te perdoret ne ditën D.

Procedura e llogaritjes dhe e alokimit te kapacitetit transmetues ditor eshte:

- Deri ne ora 10:00 te cdo dite, pjesmarresit e tregut qe kane fituar te drejten e transmetimit ne ankandin vjetor/mujor, duhet te deklarojne sasine e kapacitetit ne MW, vecmas per cdo kufi e drejtim, qe kane planifikuar te perdorin ne ditën D+2,
- Deri ne ora 11:00 te cdo dite, OST publikon ne faqen e vet te internetit, ose njofton pjesmarresit e tregut per kapacitetin disponibel per ditën D+2 per cdo kufi e drejtim, si dhe shkemben informacionin perkates me TSO-te fqinje lidhur me kapacitetin ‘e kthyer’ dhe ate disponibel per ditën D+2,
- Deri ne ora 14:00 te cdo dite, OST pranon kerkesat e pjesmarresve te tregut per kapacitet transmetues per ditën D+2, ne perputhje me njoftimin perkates te bere nga ana e saj,
- Deri ne ora 15:00 te cdo dite, OST ben alokimin e kapacitetit ne menyre proporcionale me kerkesat, per cdo kufi dhe drejtim te fluksit, dhe njofton pjesmarresit per kapacitetin respektiv qe i eshte alokuar per ditën D+2.

Ne mungese te platformes se Softit, alokimi ditor do te behet me e-mail, ne adresen e publikuara nga OST.

5.2 Paraqitja e kerkeses per alokim kapaciteti ne ankandet vjetore/mujore/ditore

Paraqitja e kerkeses per rezervim te se drejtes se perdorimit te kapacitetit nderkufitar do te behet me zarfe te mbyllur, per ankandet vjetore dhe mujore dhe e-mail per alokimin ditor, ne adresen qe jepet nga OST sipas procedurave te percaktuara ne kete rregullore.

Kapaciteti i alokuar nga OST nenkupton te drejten e perdorimit te kapacitetit nderkufitar ne bande per cdo ore te periudhes perkatese te rezervimit.

Me paraqitjen e kerkeses per rezervim te kapacitetit te transmetimit nderkufitar, pjesmarresi ne ankand merr persiper detyrimin e berjes se pageses te ATC te fituar sipas rezultateve te ankandit.

5.3. Mekanizmi i zhvillimit te ankandeve

Kapacitetet e Transmetimit Disponibel (ATC) alokohen me procedure ankandi nga OST ne formen e te Drejtes se Transmetimit Fizik, ne cdo linje interkonjeksioni dhe drejtim sipas termave dhe dispozitave te ketyre Rregullave.

Ne nje procedure ankandi OST klasifikon te gjitha ofertat e vlefshme si vijon:

Rasti 1:

Nese shuma e te gjitha ofertave te vlefshme te dorezuara per nje ankand te caktuar eshte e barabarte ose me pak se Kapacitetet e Transmetimit Disponibel (ATC), pjesemarresit fitojne te drejten e transmetimit sipas ofertes se paraqitur pa kryer asnje pagese kundrejt OST.

Rasti 2:

Nese shuma e te gjitha ofertave te vlefshme te dorezuara per nje ankand te caktuar e kalon sasine e Kapaciteteve te Transmetimit Disponibel (ATC), per fituesin e te Drejtes se Transmetimit Fizik caktohet cmimi per cdo MWh te alokuar. Per kete qellim, ofertat renditen ne baze te cmimit te ofruar, duke filluar me cmimin me te larte dhe perfunduar me cmimin me te ulet.

Ofertat e vlefshme renditen sipas nje liste me prioritet cmimin me te larte te ofertes. Cmimi i ankandit eshte cmimi marginal, pra cmimi i ofertes me te ulet te pranuar ne ankand.

Cmimi perfundimtar i percaktuar sipas parimeve te mesiperme perdoret si baze per perlogaritjen e cmimit te kapaciteteve dhe aplikohet tek te gjithe mbajtesit e te Drejtes se Transmetimit Fizik.

Pjesmarresit ne ankand mund te paraqesin deri ne 10 oferta per cdo kufi/drejtim fluksi dhe periudhe kohore te percaktuar ne njoftimin e ankandit. Oferta qe paraqitet ne ankand perfaqeson nje cift vlerash kapacitet – cmim (MW - €/MWh). Cmimi i ofertes nuk perfshin tatimin mbi vleren e shtuar (TVSH), qe llogaritet vecmas nga OST.

Vlera minimale e kapacitetit qe kerkohej ne nje oferte eshte 1 MW dhe vlera maksimale e ofertes dhe/ose ofertave te cdo pjesemarresi eshte i/e barabarte me vleren e ATC te ofruar ne ankand nga OST. Cmimi i ofertes jepet ne €/MWh, me dy shifra dhjetore, dhe vlera minimale e cmimit qe mund te ofrohet eshte 0.01 €/MWh.

Oferta e fundit e pranuar mund te reduktohet ne rast se kapaciteti i mbetur eshte me i vogel se kapaciteti i kerkuar. Ne rast se per kapacitetin e mbetur, ka dy ose me shume oferta me cmim te njejte, atehere reduktimi i kapacitetit behet ne menyre proporcionale me kapacitetin e kerkuar per cdo oferte duke bere rrumbullakimin ne vleren e plote me te vogel.

Me paraqitjen e Kerkeses, pjesemarresi, pranon se oferta e tij mund te reduktohet sipas procedures se ankandit eksplicit (ne rast se oferta e tij eshte e fundit ne liste dhe nuk mund te realizohet plotesisht), dhe cmimi i ofruar eshte i vlefshem per cdo reduktim te kapacitetit.

Ne rast se shumica e kapaciteteve te ofertave, per nje kufi, drejtim dhe intervalin kohor respektiv, eshte me e madhe se kapaciteti disponibel (ATC) i publikuar sipas procedures se ankandit, atehere pjesmarresit qe kane fituar te drejten e transmetimit ne ankand, jane te detyruar te paguaje rezervimin e kapacitetit nderkufitar, te llogaritur sipas formules:

Pagesa (€) = [cmimi marxhinal (€/MWh) x kapaciteti i alokuar (MW) x numri i oreve te periudhes se ankandit (oreve te muajit ose nje pjese te tij)]

5.4. Njoftimi i rezultateve te ankandit

Me mbarimin e procedures se ankandit vjetor dhe mujor, OST njofton cdo pjesemarres te ankandit dhe publikon brenda dy diteve kalendarike nga dita e zhvillimit te ankandit ne faqen e vet te internetit, lidhur me rezultatet duke i derguar nje informacion ne forme elektronike sipas tabelës te shtojces nr.2.

Pjesmarresi fitues, brenda dites se nesërme te marrjes se njoftimit, nenshkruan kontraten model “Mbi te drejten e perdorimit te kapacitetit transmetues nderkufitar ne kufijte e zones se kontrollit te OST-se”, sipas shtojces nr. 5. Kontrata

nenshkruhet vetem njehere nga pjesmarresi fitues dhe eshte e vlefshme per te gjitha te drejtat e fituara ne ankandet vjetore dhe/ose mujore dhe/ose ditore.

Pjesmarresit ne ankand mund te kerkojne sqarime ne OST lidhur me rezultatet e ankandit, jo me vone se ora 12:00 e dites pas marrjes se njoftimit perkates nga OST. OST jep pergjigje ne lidhje me keto kerkesa per sqarim brenda ores 14:00 te te njejtës dite. Nese pjesmarresi ne ankand nuk paraqet ndonje ankim brenda kohes se caktuar, atehere rezultati i njoftuar konsiderohet perfundimtar dhe sherben si baze per llogaritjen e pageses se rezervimit dhe faturimit.

5.5. Llogaritja e pageses per rezervimin e kapacitetit nderkufitar dhe taksa e vleres se shtuar

a) Ankandi vjetor/mujor

Pagesa per rezervimin e kapacitetit nderkufitar te alokuar ne ankandet vjetore/mujore, llogaritet ne baze mujore sipas sasise ne MWh te alokuar ne ankand dhe cmimit perkates te ankandit. Pagesa do te behet ne avance, para fillimit te perdorimit te se drejtes se transmetimit, sipas fatures qe emetohet nga OST jo me vone se 5 dite para fillimit te muajit ne te cilin do te perdoret e drejta e transmetimit. OST i dergon nje fature me baze mujore cdo pjesmarresi te shpallur fitues ne ankandin vjetor/mujor. Ne kete fature, llogaritet dhe shenohet vecante, shumes se kalkuluar sipas formule se mesiperme per perdorimin e kapacitetit, edhe taksa e vleres se shtuar (TVSH te. Secila nga shumet e mesiperme si dhe totali i tyre, paraqiten ne fature ne euro (€). Pjesmarresit do te paguajne shumen totale te shenuar ne fature.. Afati i fundit i pageses se fatures eshte 3 dite pas marrjes se fatures te leshuar nga OST. Fatura duhet te paguhet e plote, pa asnje reduktim apo kompensim, ne llogarine e OST, brenda afatit. Ne rast se pjesmarresi deshton ne kryerjen e pageses brenda afatit , atehere ai humbet te drejten e perdorimit te kapacitetit transmetues te alokuar per muajin perkates , dhe nuk do te lejohet te marre pjese ne ankandin e muajit pasardhes, deri sa te paguaje shumen e plote te fatures dhe interesin perkates te llogaritur sipas kohe-voneses.

Ne rast vonese per pagesen, OST do te ngarkoje pjesmarresin edhe me interesin ne normen e interesit bankar. Me norme te interesit bankar, do te kuptohet norma e interesit te depozitave nje ditore te aplikuar nga Banka e Shqiperise ne marredheniet e saj me bankat e nivelit te dyte, te publikuar nga Banka e Shqiperise, ne ditën me te afert nga dita e pare e llogaritjes se interesave te voneses.

b) Te dhenat e fatures

Fatura tatimore do te shoqerohet nga nje detajim i saj (sipas shtojces nr.3),te cilat se bashku do te perbejne setin e dokumentave te pageses.

Seti i dokumentave te pageses, do te dergohet dorazi dhe/ose me poste.

6. TRANSFERIMI I KAPACITETIT TE ALOKUAR

Pjesmarresi qe ka fituar ne ankandet e zhvilluara nga OST-ja, te drejten e perdorimit te kapacitetit nderkufitar, nuk mund ta ktheje kete kapacitet ne OST, qofte edhe pjeserisht, ne shkembim te kthimit te pageses perkatese qe ka bere pavaresisht nga aresyeja e pamundesise se perdorimit te ketij kapaciteti ne perputhje me parimin "Perdore ose Humbe" (UIOLI).

Pjesmarresi mund ta transferoje kapacitetin e fituar ne ankand tek nje ose disa pjesmarres te tjere te tregut te energjise elektrike ne Shqiperi. Transferimi tek nje ose me shume pjesmarres te tjere te tregut, mund te behet vetem pas njoftimit te OST. OST do hartoje proceduren e njoftimit te saj nga ana e pjesmarresve te tregut.

Kerkesa per transferim kapaciteti eshte e detyrueshme per te dy palet, dhe pas dergimit te saj ne OST, ajo nuk mund te ndryshohet apo te terhiqet. Pjesmarresit e tregut mund te transferojne kapacitetin ne sasine e plote ose te pjeseshme. Kapaciteti minimal qe mund te transferohet eshte 1 MW. Kapaciteti mund te transferohet per te gjitha periudhen e rezervuar ose per nje pjese te saj. Periudha minimale eshte nje dite (24 ore).

Transferimi i kapacitetit mund te realizohet vetem nga pjesmarresi qe ka kryer pagesen per rezervimin e kapacitetit sipas fatures se derguar nga OST per muajin perkates kur behet transferimi, gjithashtu pjesmarresi qe perfiton kapacitetin nuk duhet te kete detyrime te pashlyera kundrejt OST, e cila per realizimin e transferimit te kapacitetit ndermjet paleve, nuk i ngarkon ato me ndonje detyrim financiar.

Kerkesa per transferim te kapacitetit vjetor/mujor depozitohet prane OST jo me vone se 3(tre) dite pune perpara dites se caktuar per te bere transferimin. Ne rast te kundert, transferimi nuk behet efektiv.

7. ZBATIMI I TE DREJTES SE PERDORIMIT TE KAPACITETIT NDERKUFITAR TE ALOKUAR

E drejta e perdorimit te kapacitetit te alokuar, zbatohet nepermjet nominimit te skedulimeve te shkembimit nderkufitar, ne perputhje me Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut ne fuqi.

Pjesmarresi i tregut qe fiton te drejten e perdorimit te kapacitetit nderkufitar nga ankandi i organizuar nga OST, e aplikon kete te drejte nepermjet nominimit te skedulimeve te shkembimit nderkufitar.

Ne rast se e drejta e perdorimit te kapacitetit jepet nga Operatoret fqinje, pjesmarresi i tregut qe e perfiton kete te drejte eshte i detyruar te njoftoje OST nepermjet plotesimit te formularit perkates qe eshte pjese integrale e ketyre Rregullave (shtojca nr. 7), dhe qe dergohet me faks ose dorazi ne OST, jo me vone se tre dite punepara fillimit te muajit perkates ose para dites kur e drejta e transmetimit behet efektive. Ky formular eshte subjekt i miratimit nga OST.

Vlerat e nominuara ne skedulimin nderkufitar nuk mund te tejkalojne kapacitetin total te transmetimit te alokuar per cdo pjesmarres.

E drejta e perdorimit te kapacitetit nderkufitar ekzekutohet ne baze te principit “përdore-ose-humbe” dhe ne perputhje me Kodin e Transmetimit.

Te gjithë zoteruesit e kapaciteteve vjetore dhe mujore duhet qe te deklarojne perdorimin e kapaciteteve jo me vone se dita D-2, ora 10:00 per ditën D.

Ne rast te mos deklarimit te perdorimit te kapacitetit, pjesmarresit perkates do ti hiqet e drejta e transmetimit per ditën (D) dhe kapaciteti perkates do ti jepet pjesmarresve te tjere te tregut sipas procedures se alokimit ditor.

8. KUFIZIMI I TE DREJTES SE PERDORIMIT TE KAPACITETIT TE ALOKUAR NE ANKAND

Kapaciteti transmetues ne Interkonjeksion, i rezervuar ne ankandet e OST eshte i garantuar nga OST. OST eshte e detyruar te beje te gjitha perpjekjet per te siguruar realizimin e se drejtes se perdorimit te kapacitetit nderkufitar te alokuar ne ankande. OST mund te reduktojë vlerat e paracaktuara te kapacitetit nderkufitar, te alokuar ne ankandet vjetore/mujore, per shkaqe teknike ne kohen para perdorimit ose gjate periudhes se perdorimit te kapacitetit. Reduktimi i kapacitetit te rezervuar ne ankand behet sipas procedures se percaktuar ne keto rregulla dhe ne rastet e pershkruara ne Rregullat e Tregut.

E drejta e perdorimit te kapacitetit nderkufitar per cdo pjesmarres dhe ne cdo kufi/drejtimit te alokuar *ne ankandet vjetore*, mund te reduktohet pjeserisht ose plotesisht, per nje periudhe te caktuar kohe, per shkaqe teknike te planifikuara dhe te njohura ne avance (te skeduluara), si dhe per shkaqe qe nuk mund te planifikohen ose parashikohen ne avance (te pa skeduluara).

Ne rastet e reduktimit te perdorimit te kapacitetit per shkaqe te skeduluara, pjesmarresit (zoteruesit e kapacitetit) do te njoftohen per kete, jo me vone se 10 dite para fillimit te muajit perkates kur eshte planifikuar te behet reduktimi i kapacitetit nderkufitar. Reduktimi do te behet ne menyre proporcionale sipas kapacitetit qe ka fituar secili pjesmarres ne kufirin/drejtimin perkates.

Reduktimi i kapacitetit nderkufitar te alokuar ne ankandet vjetore/mujore, per shkaqe te pa skeduluara perfshin reduktimin e kapacitetit neto (NTC) per shkaqe te papritura, ne kushtet e emergjences ne Sistemin Elektroenergjetik te vendit dhe/ose ne Sistemet e vendeve fqinje, sipas percaktimit te bere ne Kodin e Transmetimit, ne rastet e veprimit te Forcave madhore, si dhe ne rastet e kur OST ka pezulluar tregun e energjise elektrike sipas parashikimeve ne kap. XIII te Rregullave te Tregut.

OST nuk kompenson pjesemarresit per reduktimin e kapacitetit transmetues ne interkonjeksion ne rastet e parashikuara ne kete kapitull.

OST mund te pezulloje te drejten e perdorimit te kapacitetit nderkufitar ne muajin perkates per cdo pjesmarres, nese zoteruesi i kapacitetit deshton ne plotesimin e rregullave te OST dhe ENTSO-E lidhur me nominimin dhe harmonizimin e skedulimeve te shkembimit, si dhe nese zoteruesi i kapacitetit ka detyrime financiare te pashlyera kundrejt OST. Ne kete rast zoteruesi i kapacitetit humbet te drejten e pjesmarrjes ne ankandin e muajit te ardhshem, deri sa te plotesoje te gjitha detyrimet kundrejt OST-se.

9. PUBLIKIM I INFORMACIONIT NE FAQEN E INTERNETITTE OST

Informacioni minimal i detyruar per t'u publikuar ne faqen e internetit te OST permban;

- a. Rregullat e Ankandit dhe te gjitha udhezimet dhe procedurat qe jane ne fuqi dhe kane te bejne me alokimin e kapacitetit ne interkonjeksion
- b. Njoftimet sipas Rregullave te Ankandit;
- c. Njoftimin e te dhenave te Ankandit te rradhes;
- e. Formularet dhe dokumentat qe do shkarkohen dhe perdoren nga perdoruesit ne lidhje me Ankandin;
- f. Tabelen e rezultateteve te Ankandit
- g. Kufizimet e Planifikuara;
- h. Periudhat e Remontit (shtojca nr 6);
- i. Kalendari tregues per ankandet vjetore dhe mujore;
- j. Lista e Pjesmarresve ne Ankand (shtojca nr 8);
- k. Informacione te tjera perkatese.

10. MONITORIMI I ALOKIMIT TE KAPACITETEVE

Te gjitha operacionet e alokimit do te dokumentohen me saktesi. Asnje alokim nuk lejohet te kryhet pa dokumentacionin shoqerues te kerkuar.

Deri me date 10 te cdo muaj OST Sh.a paraqet ne ERE nje raport analitik informues dhe argumentues mbi alokimin e kapaciteteve ne zbatim te ketyre rregullave.

OST Sh.a ka detyrimin t'i jape ne menyre transparente ERE-s te gjithe dokumentacionin e kerkuar prej saj, per Alokimet e Kapaciteteve te Interkonjeksioneve ne kuader te autoritetit te ERE per te monitoruar te licensuarit.

11. MIRATIMI DHE RISHIKIMI

Keto Rregulla miratohen dhe jane objekt rishikimi me vendim te Bordit te Komisionereve sipas Rregullave te Praktikes dhe Procedurave te ERE-s.

12. HYRJA NE FUQI

Keto rregulla hyjne ne fuqi ne daten e miratimit te tyre nga ana e Bordit te Komisionereve dhe do kenë vlefshmëri deri në momentin e hyrjes në operim të Zyrës Rajonale të Koordinimit të Ankandëve në Podgoricë.

SHTOJCA 1

Formulari i Paraqitjes se Ofertes


Ofertë për rezervim të kapacitetit transmetues ndërkufitar

Kompania	(Emri Kompanisë)
Kufiri	
Drejtimi	
Periudha	(sipas publikimit të OST)
ATC	xx MW (sipas publikimit te OST)

Nr	Kapaciteti	Çmimi
	[MW]	[€/MWh]
1	xx	x.xx
2	xx	x.xx
3	xx	x.xx
4	xx	x.xx
5	xx	x.xx
6	xx	x.xx
7	xx	x.xx
8	xx	x.xx
9	xx	x.xx
10	xx	x.xx
Shuma	Σ	

SHTOJCA 2

Formular i Njoftimit te Rezultateve te Ankandeve

			OPERATORI I TREGUT					Dt. __/__/__		
<u>REZULTATI E ANKANDI MUJOR</u>										
KUFIRI / DREJTIMI	KODI	ATC	PERIUDHA	Kompanite Fituese	Kapaciteti I Fituar	KAPACITETI TOTAL I KERKUAR	KAPACITETI TOTAL I ALOKUAR	NR I PJESMARE SVE NE ANKAND	NR I PJESMARR ESVE QE FITOJNE TE DREJTEN E TRANSMETIMIT	NR.I OFERTAVE
		MW				MW	MW			
Shqipëri -Mal I Zi	AL-ME									
Shqiperi -Kosove	AL-KS									
Shqiperi- Greqi	AL-GR									
Mal I Zi- Shqiperi	ME-AL									
Kosove-Shqiperi	KS-AL									
Greqi-Shqiperi	GR-AL									

SHTOJCA 3

Formulari i Detajeve te Fatures

Kufiri	Drejtimi	Kompania	Tipi i alokimit	Kapaciteti	Cmimi	Periudha	Shuma	TVSH	Σ me TVSH
				[MW]	[€/MWh]	[ore]	[€]	[€]	[€]
Kosove-Shqiperi	Import								
Kosove-Shqiperi	Import								
Shqiperi-Kosove	Eksport								
Shqiperi-Kosove	Eksport								
Greqi-Shqiperi	Import								
Greqi-Shqiperi	Import								
Shqiperi-Greqi	Eksport								
Shqiperi-Greqi	Eksport								
Mali Zi-Shqiperi	Import								
Mali Zi-Shqiperi	Import								
Shqiperi-Mali Zi	Eksport								
Shqiperi-Mali Zi	Eksport								

SHTOJCA 5

Modeli i Kontrates

- 1. Operatori i Sistemit te Transmetimit Shqiptar (OST sh.a.), Tirane, Bulevardi ‘Gjergj Fishta’ Nr. 10, me numer regjistrimi _____, me numer takse identifikimi _____, i perfaqesuar nga drejtori i kompanise _____,**

dhe

- 2. xxx _____, (adresa, nr. Regjistrimi, nr. Identifikimi takse), i perfaqesuar nga _____ ,**

Jane pale ne kete Kontrate dhe bien dakort si vijon:

KONTRATE

Mbi

Te drejten e perdorimit te kapacitetit transmetues nderkufitar, ne kufijte e zones se kontrollit te OST-se, per periudhen _____

Neni 1

Subjekti i Kontrates

1.1 Kjo Kontrate specifikon te drejttat dhe obligimet e ndermjet OST dhe xxx si pjesmarres ne tregun e energjise ne Shqiperi, lidhur me alokimin e kapacitetit transmetues disponibel (ATC) ne ankandet vjetore dhe mujore, dhe ushtrimin e te drejtes per te perdorur kapacitetin e alokuar dhe nominimin e skedulimeve

1.2 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, xxx deklarone se ka njohje te plote, dhe ne menyre te pakthyeshme pranon pa rezerva ose limitime “Rregullat per alokimin e kapacitetit nderkufitar ne kufijte e zones se kontrollit te menaxhuar nga OST (ketu me poshte referuar si “Rregullat”); qe jane percaktuar nga OST dhe publikuar ne faqen e saj te internetit.

Neni 2

Perdorimi i kapacitetit nderkufitar te alokuar

2.1 XXX shfrytazon te drejten e tij per perdorimin e kapacitetit transmetues nderkufitar duke marre pjese ne ankandet e kapaciteteve te organizuara nga OST ne akordance me Rregullat e alokimit te kapacitetit nderkufitar.

2.2 XXX shfrytazon perdorimin e kapacitetit te alokuar me ane te nominimit te shkembimeve nderkufitare, qe ja dergon OST ne akordance me Rregullat e Tregut, Kodin e Rrjetit, Rregullat e ENTSO-E, Rregullat dhe dokumentet mbi mundesine e reduktimit te import/eksportit te energjise elektrike konform Rregullave te Tregut.

2.3 E drejta e perdorimit te kapacitetit transmetues nderkufitar qe i eshte alokuar XXX ne ankandet vjetore, mujore, nuk eshte e garantuar nga OST, pasi vlera e percaktuar paraprakisht e kapacitetit nderkufitar ne nivel vjetor, mujor, ditor mund te zvogelohet para momentit te perdorimit te kapacitetit te alokuar. Ky reduktim do te behet ne menyren dhe sipas kushteve te percaktuara ne Rregullat e Tregut.

2.4 XXX nuk i jepet e drejta e rimbursimit te demit ose humbjes se fitimit, per shkak te reduktimit te se drejtes te perdorimit te kapacitetit nderkufitar, per shkaqe per te cilat OST nuk eshte pergjegjese.

Neni 3

Faturimi dhe pagesa e vlerave

3.1 Vlera ete drejtes te perdorimit te kapacitetit nderkufitar, per kapacitetin e alokuar ne ankande (vjetor dhe mujor), do te kalkulohet ne baze mujore sipas

numrit te planifikuar te oreve te perdorimit te mundeshem te kapacitetit nderkufitar. XXX eshte i detyruar te paguaje ne OST shumen e plote te vleres per rezervimin e kapacitetit nderkufitar qe i eshte alokuar ne ankand. XXX do te paguaje vleren perpara fillimit te perdorimit te se drejtes se transmetimit, sipas fatures se emetuar nga OST.

3.2 Ne fature, vlera e TVSH, i shtohet shumes se vleres se kapacitetit, sipas legjislacionit perkates ne fuqi. Secila prej shumave te lartpermendura si dhe totali do te paraqiten ne fature ne euro (EUR). XXX eshte i detyruar te paguaje shumen totale te shenuar ne fature. Pagesa e fatures do te behet ne llogarine e OST ne Lek ne vlere te barabarte me shumen ne Euro te fatures, sipas kursit te Bankes Shqiptare ne ditën e pageses. Instruksione mbi pagesen jepen ne fature.

Kushtet e pergjithshme te Faturimit

3.3 Per perdorimin e kapacitetit te alokuar ne ankande, XXX duhet te beje pagesen e shenuar ne fature, ne avance, per cdo muaj, ne llogarine e OST ne banken qe deklarohet ne fature.

3.4 OST do te emetoje faturen perkatese per XXX per kapacitetin e alokuar ne ankand, jo me vone se 5 (pese) dite para fillimit te muajit qe vjen, per te cilin eshte dhene e drejta e perdorimit te kapacitetit. Seti i dokumentave te pageses, do te dergohet dorazi dhe/ose me poste.

3.5 Fatura e derguar nga OST duhet te paguhet brenda 3(tre) diteve pune nga dita e emetimit. Pagesa konsiderohet efektive kur shuma respektive e parave eshte derdhur ne llogarine e OST.

3.6 XXX eshte i detyruar te paguaje shumen e plote te faturuar, pa ndonje reduktim apo kompensim, ne llogarine e OST, brenda 3 diteve nga marrja e fatures.

3.7. Ne rast se pjesmarresi deshton ne kryerjen e pageses brenda afatit, atehere ai humbet te drejten e perdorimit te kapacitetit transmetues te alokuar per muajin perkates , dhe nuk do te lejohet te marre pjese ne ankandin e muajit pasardhes, deri sa te paguaje shumen e plote te fatures dhe interesin perkates te llogaritur sipas kohe-voneses.

3.8 Ne rast voneses per pagesen, OST do te ngarkoje pjesmarresin edhe me interesin ne normen e interesit bankar. Me norme te interesit bankar, do te kuptohet norma e interesit te depozitave nje ditore te aplikuar nga Banka e Shqiperise ne marredheniet e saj me bankat e nivelit te dyte, te publikuara nga Banka e

Shqiperise, ne ditën me te afert nga dita e pare e llogaritjes se interesave te voneses.

Neni 4

Amendamentet e te Drejtave dhe Detyrimeve

4.1 XXX mund te beje transferimin e kapacitetit nderkufitar ne menyren dhe sipas kushteve te pershkruara ne Rregullat.

4.2 Palet njohin dhe pranojne se kjo eshte nje kontrate tip dhe si shtojce e Rregullave, mund te ndryshohet vetem me Vendim te Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Neni 5

Zgjidhja e Mosmarveshjeve

5.1 Palet do te mundohen te zgjidhin mosmarveshjet e mundeshme gjate zbatimit te kesaj kontrate, ne menyre miqesore.

5.2 Nese mosmarveshja nuk mund te zgjidhet ne menyre miqesore, ajo do te zgjidhet nepermjet gjykates kompetente.

5.3 Gjate kohes se zgjidhjes se mosmarveshjes, Palet nuk do te nderpresin performancen e Kontrates, vetem nese rrethanat e rastit dhe/ose Rregullat kerkojne nderprerjen ose pezullimin e disa te drejtave te perdorimit te kapacitetit te alokuar.

Neni 6

Hyrja ne fuqi e Kontrates

6.1 Kjo Kontrate do te hyje ne fuqi ne datën e nenshkrimtit te saj nga perfaqesuesit e autorizuar te Paleve.

6.2 Kjo Kontrate eshte bere ne tre kopje identike, nje per XXX dhe dy per OST.

Nenshkrimi i perfaqesuesve te autorizuar

Per OST

Per XXX

SHTOJCA 6

Plani Vjetor Paraprak i Remonteve te Interkonektoreve

Interkonektori	Periudha	
	Nga data	Deri me date
Shqiperi – Mali Zi Linja 400 kV		
Shqiperi – Mali Zi Linja 220 kV		
Shqiperi - Kosove		
Shqiperi - Greqi		

SHTOJCA 7

Miratohet Personi i Autorizuar nga OST

Formulari i Deklarimit te ATC te rezervuar ne TSO fqinje

Rezervimi eshte bere ne TSO_ne : (MEPSO ose EMS ose HTSO)

Interkonjeksioni : (AL-ME ose AL-RS ose AL-GR)

Drejtimi per OST : (Import ose Export)

Periudha e rezervimit : (nga : dd.mm.yyyyderi : dd.mm.yyyy)

Madhesia e kapacitetit transmetues te rezervuar : (MW)

Subjekti qe ka bere rezervimin :

Emri i Kompanise :
Kodi ne Treg :
Adresa :
Te. / Fax. / E-mail :

Per Kompanine
(Personi i Autorizuar)

Shenime :

Kapaciteti i Deklaruar ne kete formular nuk eshte subjekt i nominimit ne OST

*Ky formular dergohet ne OST, me faks ose poste jo me vone se 3 dite para fillimit te muajit
OST konfirmon marrjen e ketij Deklarimi me E-mail*

Ky formular eshte subjekt i miratimit nga OST

SHTOJCA 8

LISTA E PJESMARRESVE TE TREGUT QE MUND TE MARRIN PJESE NE ANKAND						
NR	EMRI I PJESMARRESIT	KODI	ADRESA	DATA E REGJISTRIMIT	PERSONAT E AUTORIZUAR	TIPI I VEPRIMTARISE
1						
2						
3						
4						
5						
6						

SHTOJCA 9

NJOFTIM PER ANKAND VJETOR/MUJOR

Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. njofton shpalljen e ankandit të alokimit të kapaciteteve vjetore/mujore të interkonjeksioneve për Vitin...../ Muajin (periudha deri më), sipas tabelës së mëposhtme të kapacitetit disponibël:

Kufiri Shqipëri -Kosovë;

Drejtimi	Periudha	Kapaciteti ATC [MW]
Eksport ora 00:00, deri më
OST --> EMS ora 24:00, CET	
Import ora 00:00, deri më
EMS --> OST ora 24:00, CET	

Kufiri Shqipëri –Mali Zi;

Drejtimi	Periudha	Kapaciteti ATC [MW]
Eksport ora 00:00, deri më
OST --> CGES ora 24:00, CET	
Import ora 00:00, deri më
CGES--> OST ora 24:00, CET	

Kufiri Shqipëri -Greqi;

Drejtimi	Periudha	Kapaciteti ATC [MW]
Eksport ora 00:00, deri më
OST --> HTSO ora 24:00, CET	
Import ora 00:00, deri më
HTSO --> OST ora 24:00, CET	

Ankandi do të hapet ditën e**dt.....** /...../..... ora në adresën:

.....